Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 038
Datë: 27.08.2008.

Në mbështetje të nenit 94 pika 3, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, Kryeministri i Kosovës, mori:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PUNUES PËR INTEGRIM EVROPIAN

1. Qëllimi i Vendimit

Qëllimi i këtij Vendimi është themelimi i Komitetit Punues për Integrim Evropian brenda Qeverisë së Kosovës (referuar më tutje në këtë Vendim si 'Komiteti').

Komiteti do të jetë organi koordinues shtetëror në nivelin e Sekretarëve të Përhershëm të ministrive dhe Kryesueseve të organeve shtetërore, të cilat, brenda spektrit të funksioneve dhe të drejtave të veta, sigurojnë bashkëpunimin e ministrive dhe organeve tjera shtetërore në çështjet që lidhen me integrimin e Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian.

2. Funksionet e Komitetit

Komiteti ka këto funksione:

- Të konsiderojë propozimet e ministrive dhe organeve tjera shtetërore për prioritetet e Qeverisë së Kosovës lidhur me integrimin në Bashkimin Evropian;
- Të përpunojë propozimet lidhur me politikat uniforme të Qeverisë së Kosovës në fushat që lidhen me integrimin në Bashkimin Evropian;
- Të pajtohet në ndarjen e përgjegjësive në mes të ministrive dhe organeve tjera shtetërore lidhur me përmbushjen e prioriteteve të Qeverisë së Kosovës në fushat

e integrimit Evropian, posaçërisht të Planit të Veprimit për Partneritetin Evropian dhe të monitorojë rregullisht progresin e zbatimit të dokumentit të lartpërmendur;
- Të diskutojë të gjitha çështjet që lidhen me negociatat me Komisionin Evropian për Marrëveshjen e Përkohshme dhe Shtetet Anëtare të BE-së;
- Të konsiderojë të gjitha mosmarrëveshjet në mes të organeve shtetërore që lindin nga zbatimi i Partneritetit Evropian dhe Planit të Veprimit për Partneritetin Evropian të Qeverisë së Kosovës, si dhe nga dokumente tjera planifikuese në fushen e Integrimit Evropian, të aprovuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës;
- Të konsiderojë dhe të pajtohet me propozimet e ministrive përgjegjëse për përpunimin e akteve ligjore të Republikës së Kosovës;
- Të diskutojë çështjet e zhvillimit dhe drejtimit të programeve dhe aktiviteteve që kanë të bëjnë me ndërtimin e kapaciteteve të ministrive dhe organeve tjera shtetërore;
- Të diskutojnë çështjet për koordinimin e shfrytëzimit të ndihmës së BE-së dhe ndihmës bilaterale të donatorëve nëse kjo e fundit i drejtohet çështjeve të integrimit Evropian;
- Të kërkojë nga të gjitha ministritë dhe organet tjera shtetërore, me ndihmën e Agjencisë për Integrim Evropian që ka rolin e Sekretariatit - opinionet dhe informacionet në çështjet që lidhen me secilin aspekt të procesit të integrimeve të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian.

3. Përbërja e Komitetit

1. Komiteti do të përbëhet nga:
   1.1. Kryesuesi – Zëvendës Kryeministri përgjegjës për Integrim Evropian;
   1.2. Zëvendës Kryesuesi – Ministri i Ekonomisë dhe Financave;
   1.3. Anëtarët – Sekretarët e Përhershëm të ministrive dhe kryesuesit e Doganave, Administratës Tatimore, Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, dhe Entit Statistikor të Kosovës.
   1.4. Sekretari - Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë për Integrim Evropian.

2. Kryesuesit e ndonjë organit tjetër shtetërorë të Kosovës mund të ftohen nga Kryesuesi për pjesëmarrje në takim të Komitetit nëse pika e agjendës është Brenda kompetencave të tyre.

3. Në rast të mungesës Zëvendës Kryesuesit apo anëtarit të Komitetit, ministria në fjalë apo organit shtetërorë do të emërojnë zëvendësuesin për takim, dhe do ta informojnë Agjencinë për Integrim Evropian me shkrim për këtë zëvendësim para se të mbahet takimi.

4. Secili anëtarë i Komitetit mund të ftojë ekspertë nga ministria e vet apo organi shtetërorë në rast se pika e agjendës kërkon ekspertizë specifike.

4. Zbatimi i Vendimit

Për zbatimin e këti Vendimi ngarkohen Zëvendës-Kryeministrit i Kosovës, Ministrit relevante, Agjencia për Integrim Evropian, Doganat, Administrata Tatimore, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe Enti Statistikor i Kosovës.

5. Rrregullat e procedurës

Rregullat e procedurës për Komitetin Punues do të aprovohen në mbledhjen e parë konstituive të Komitetit.

6. Hyrja në Fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAQI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Të gjitha Ministrive (Ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-së
- AIE
- Arkivit të Qeverisë

4. Zbatimi i Vendimit

Për zbatimin e këti Vendimi ngarkohen Zëvendës-Kryeministrit i Kosovës, Ministrit relevante, Agjencia për Integrim Evropian, Doganat, Administrata Tatimore, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe Enti Statistikor i Kosovës.

5. Rrregullat e procedurës

Rregullat e procedurës për Komitetin Punues do të aprovohen në mbledhjen e parë konstituive të Komitetit.

6. Hyrja në Fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAQI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Të gjitha Ministrive (Ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-së
- AIE
- Arkivit të Qeverisë